

VENDIM
Nr.14, datë 11.3.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË
BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.9.2002, ndryshuar me vendimin nr.3, datë 26.1.2005, ndryshuar me vendimin nr.80, datë 25.10.2006.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË
BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:

- a) licencimin e bankës dhe degës së bankës së huaj për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë;
- b) miratimin e veprimtarive shtesë të bankës dhe degës së bankës së huaj;
- c) zgjerimin e rrjetit bankar pas licencimit të bankës dhe degës së bankës së huaj;
- d) detyrimet për njoftim në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së bankës dhe degës së bankës së huaj;
- e) dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së bankës dhe degës së bankës së huaj; si dhe
- f) riorganizimin juridik të bankës (bashkimi, ndarja).

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të:
- ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 1, pika 4, shkronja “b”; neni 3, pika 4, shkronja “c” dhe nenit 12, shkronja “a”.

- kreut II të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”.
- ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

- ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë personat që kërkojnë të licencohen për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të nenit 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Riblerje e aksioneve të bankës ose riblerje e aksioneve të personave të lidhur me të” do të ketë kuptimin e përcaktuar sipas ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

b) “Bashkimi me përthithje” është bashkimi i dy ose më shumë bankave nëpërmjet transferimit të totalit të aktiveve dhe të pasiveve të bankës/ave të përthithur/a të një bankë tjetër ekzistuese, e quajtur banka përthithëse. Kjo formë riorganizimi sjell prishjen e bankës/ave të përthithur/a, në këmbim të zotërimit të aksioneve nga aksionarët e bankës/ave të përthithur/a në bankën përthithëse.

c) “Bashkimi me krijim” është bashkimi i dy ose më shumë bankave ekzistuese për të themeluar një bankë të re, ku bankat ekzistuese në fjalë e humbasin personalitetin e tyre juridik dhe krijohet një bankë e re. Banka e themeluar rishtazi do të zotërojë të gjitha aktivet dhe pasivet e bankave që po shkrihen, në këmbim të zotërimit të aksioneve nga aksionarët e bankës/ve ekzistuese në bankën e re.

d) “Ndarje me krijim” është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve në dy ose më shumë banka të themeluara rishtazi (pritëse), ku banka e ndarë vlerësohet e prishur pa likuidim.

e) “Ndarje me përthithje” është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit të të gjitha aktiveve apo pasiveve në dy ose disa banka ekzistuese (pritëse), ku banka e ndarë vlerësohet e prishur pa likuidim.

KREU II
LICENCIMI

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme për marrjen e licencës

1. Personi që kërkon të ushtrojë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, i paraqet një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë për marrjen e licencës. Kërkesa nënshkruhet dhe depozitohet në Bankën e Shqipërisë nga aksionarët themelues të bankës së propozuar ose nga banka e huaj në rastin kur kjo e fundit kërkon të ushtrojë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një dege ose filiali të saj. Kërkesa paraqitet në Bankën e Shqipërisë e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji për bankat dhe nga kjo rregullore, sipas formularëve bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj të fundit.

2. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të legalizuara. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga organet kompetente të një shteti të huaj, dokumentacioni të jetë i legalizuar edhe në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nga autoritetet përgjegjëse të shtetit të huaj, në përputhje me kërkesat përkatëse të legjislacionit të këtij të fundit; ose

b) sipas përcaktimeve të akteve juridike përkatëse të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë, të ratifikuara nga shteti shqiptar.

3. Përfshihet nga përcaktimi i pikës 2 të këtij neni, në rastin e subjekteve të huaja, pasqyrat financiare mund të paraqiten në gjuhën angleze.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

5. Personi, pasi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, publikon, për jo më pak se tri ditë radhazi, në dy nga gazetatat me tirazh me të madh, një njoftim lidhur me kërkesën e paraqitur prej tij për t’u licencuar si bankë ose degë e bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë. Shpenzimet e këtij njoftimi përballohen nga vetë personi që paraqet kërkesën për licencë.

Neni 6
Kërkesa për kapitalin

1. Personi/at që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet themelimit dhe licencimit të një banke, depoziton/jnë për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë një kapital fillestar minimal prej jo më pak se 1 (një) miliard lekë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 18 të ligjit për bankat.

2. Banka e huaj që kërkon të ushtrojë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet një dege të saj, depoziton për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë shumën e dhuruar të kapitalit fillestar minimal të kësaj të fundit, prej jo më pak se 1 (një) miliard lekë.

3. Pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve të bankës dhe të pajisjeve të punës, si dhe shpenzimet e tjera operative nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 7
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për licencimin e bankës dhe degës së bankës së huaj

1. Personi që kërkon të licencohet për të ushtuar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, përveç sa parashikohet në pikën 1 të nenit 17 të ligjit për bankat, paraqet në Bankën e Shqipërisë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin lidhur me arsimimin, përvojën profesionale dhe reputacionin e të paktën dy drejtuesve ekzekutivë të propozuar të subjektit, sipas kërkesave të ligjit për bankat dhe akteve rregullative të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim, të shoqëruar me një përkthim të punës dhe përgjegjësi të tyre;

b) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 13 të ligjit për bankat;

c) kur aksionarët e drejtpërdrejtë janë persona juridikë:

i) dokumentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si person juridik dhe statutin e shoqërisë;

ii) dokumentacionin ligjor përkatës se nuk ka detyrime fiskale të prapambetura për t'u paguar për periudhën më të fundit;

iii) strukturën organizative;

iv) deklaratën për pozicionin e personit juridik në grupin e shoqërive ku bën pjesë, të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i saj (në qoftë se është e aplikueshme);

v) strukturën e kapitalit të shoqërisë dhe pjesëmarrjet në shoqëritë, në të cilat aksionari i propozuar zotëron jo më pak se 10 (dhjetë) për qind të të drejtave të votës (në qoftë se është e aplikueshme), të shoqëruar me një përmbledhje të veprimtarisë/ve që këto të fundit kryejnë;

vi) listën e aksionarëve që kanë pjesëmarrje influencuese në shoqëri të tjera;

vii) deklaratën noteriale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve;

viii) të dhëna financiare që tregojnë se natyra dhe burimet financiare të aksionarit të propozuar janë të tilla që mund të sigurojnë mbështetje me kapital shtesë të veprimtarisë së bankës;

ix) vërtetime për aksionarët e propozuar, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:

- personi nuk është në ndjekje penale (kur është e aplikueshme);
- personi nuk është në gjykim për vepra penale (kur është e aplikueshme);
- personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme);
- personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;
- ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paaftësisë pague, të falimentimit ose të likuidimit

etj.

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së tyre në Bankën e Shqipërisë.

d) kur aksionarët e drejtpërdrejtë janë persona fizikë/individë:

i) kopje të legalizuar të dokumentit të identifikimit dhe një CV;

ii) informacion të plotë për interesat pasurore apo të biznesit/ve të tyre, veçanërisht listën e bizneseve ku ata mund të kenë pjesëmarrje influencuese dhe për çdo pjesëmarrje të tillë përqindjen e aksioneve/kuotave që zotërojnë në kapitalin aksionar;

iii) informacione për pjesëmarrjen e tyre në këshillat drejtues të bankave;

iv) informacione për pjesëmarrjen e tyre në këshillat mbikëqyrës/administrativë dhe/ose në organet

- drejtuese të shoqërive të tjera tregtare jobankare brenda dhe jashtë vendit;
- v) informacione për pjesëmarrjen e tyre në organet drejtuese të organizatave të biznesit;
 - vi) informacione për lidhjet e mundshme që do të ketë ndërmjet aktivitetit të tyre privat dhe bankës së propozuar, pas licencimit të kësaj të fundit;
 - vii) informacione për lidhje familjare ose të gjinisë ndërmjet aksionarëve;
 - viii) dokumentacionin ligjor përkatës se nuk ka detyrime fiskale të prapambetura për t'u paguar për periudhën më të fundit;
 - ix) deklaratë të personit fizik tregtar, ose të individit, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve (në qoftë se ka);
 - x) vërtetime të lëshuara nga organet kompetente se:
 - personi nuk është në ndjekje penale;
 - personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - personi nuk ka qenë dënuar ndonjëherë penalisht;
 - personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së tyre në Bankën e Shqipërisë.

e) Plani i biznesit i propozuar, përveç elementeve të përcaktuara në nenin 17, pika 1, shkronja “e”, të ligjit për bankat, duhet të përmbajë edhe:

- i) vlerësimin e aksionarit/aksionarëve të propozuar mbi gjendjen e sistemit bankar shqiptar, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
- ii) strategjinë e bankës së propozuar lidhur me objektivat dhe pozicionin e synuar prej saj në treg;
- iii) arsyet dhe argumentet kryesore përse aksionari/ët themelues besojnë se banka do të jetë e suksesshme, si dhe strategjinë e përgjithshme për të arritur këtë sukses;
- iv) strukturën organizative të bankës dhe numrin e parashikuar të punonjësve;
- v) numrin e degëve dhe agjencive, së bashku me vendet e afatet ku dhe kur banka planifikon t'i hapë ato;

vi) parashikimin e gjendjes financiare të bankës së propozuar për 3 (tri) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së saj (bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, *cash flow*, plani i amortizimit të shpenzimeve paraoperacionale, plani i shpërndarjes së fitimit ose i mbulimit të humbjeve etj.), duke përfshirë argumentet kryesore të përdorura për këto parashikime;

vii) identifikimin e rreziqeve ndaj të cilave banka parashikon të ekspozohet gjatë zbatimit të planit të biznesit, si dhe një përshkrim të metodave dhe të sistemeve të kontrollit që do të zbatohen prej saj për administrimin e këtyre rreziqeve. Subjekti, në hartimin e planbiznesit dhe në llogaritjen e treguesve për rreziqet e parashikuara, duhet të marrë në konsideratë kërkesat e ligjit për bankat dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, sidomos përcaktimet e këtyre të fundit për normat dhe kufijtë maksimalë të treguesve të rreziqeve;

f) vërtetimin për pagimin e komisionit të përpunimit të licencës.

2. Banka e huaj mund të ushtrojë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hapjes së një dege apo krijimit të një filiali të saj.

3. Në rastin kur subjekti që kërkon të licencohet parashikohet të jetë degë ose filial i bankës së huaj, kërkesa për t'u licencuar, përveç sa parashikohet në nenin 17 të ligjit për bankat, shoqërohet dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) skemën e organizimit dhe drejtimit të bankës së huaj;
- b) listën e administratorëve të bankës së huaj;
- c) aktet që përcaktojnë apo rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet bankës mëmë dhe degës së bankës apo filialit të saj në Shqipëri;
- d) një informacion për zhvillimet ekonomike aktuale dhe perspektive të vendit të origjinës;
- e) informacion lidhur me vlerësimin e performancës së bankës nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës dhe nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë *ratings*, nëse ka);
- f) informacion lidhur me administrimin, strategjinë, strukturën e pronësisë së kapitalit, gjendjen financiare të bankës së huaj;
- g) dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 8

Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Banka e Shqipërisë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur për licencim, në përputhje me kërkesat e ligjit për bankat dhe të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë njofton personin që ka aplikuar për licencë nëse dokumentacioni i paraqitur prej tij nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në ligjin për bankat dhe në këtë rregullore.

3. Banka e Shqipërisë publikon një njoftim pas paraqitjes së plotë të kërkesës dhe dokumentacionit për licencë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Njoftimi përmban emrin e subjektit që kërkon të licencohet, emrat e aksionarëve themelues, si dhe emrat e administratorëve kryesorë të bankës ose degës së bankës së huaj të propozuar.

4. Banka e Shqipërisë, pas paraqitjes së plotë të kërkesës për licencë, kryen veprimet e mëposhtme:

a) analizon të gjithë informacionin e siguruar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, si dhe mund të kryejë verifikimet që i çmon të nevojshme;

b) mund të organizojë dhe zhvillojë, në qoftë se e çmon të nevojshme, takime me:

I. administratorët e propozuar të bankës ose degës së bankës së huaj, dhe/ose

II. aksionarët themelues të bankës ose me përfaqësuesit ligjorë të bankës së huaj (në rast se kërkesa e paraqitur lidhet me licencimin e një dege të bankës së huaj).

Qëllimi i organizimit dhe zhvillimit të këtyre takimeve është diskutimi i objektivave në treg, planbiznesit të paraqitur, politikave kryesore të propozuara, si dhe risive që do të sjellë në treg banka apo dega e bankës së huaj etj.;

c) vlerëson, mbështetur në dokumentacionin përkatës dhe duke konsideruar rezultatet e takimit të zhvilluar me administratorët e propozuar të bankës ose degës së bankës së huaj, nëse këta të fundit kanë kualifikimin e nevojshëm për të realizuar biznesplanin e paraqitur;

d) vlerëson transparencën e strukturës së kapitalit aksionar të bankës duke analizuar faktet e mëposhtme:

I. strukturën e grupit të shoqërive në të cilën aksionari/ët themelues i propozuar është ose mund të jetë pjesë;

II. marrëdhëniet e tij me shoqëritë që ka në kontroll;

e) vlerëson burimin e krijimit të kapitalit dhe strukturën e tij;

f) vlerëson planbiznesin e paraqitur, nëse ai është real dhe bindës;

g) vlerëson në bazë të planbiznesit të paraqitur risinë që do të sjellë banka në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së saj në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;

h) analizon të ardhurat e parashikuara të bankës ose degës së bankës së huaj, duke synuar që subjekti të jetë me fitim të programuar brenda periudhës së parë trevjeçare të aktivitetit të tij;

i) vlerëson, sipas planbiznesit të paraqitur, rrezikun që parashikon të ndërmarrë banka ose dega e bankës së huaj për periudhën e parë trevjeçare të aktivitetit të saj për të krijuar bindjen se subjekti do të zhvillojë një aktivitet të sigurt dhe të suksesshëm;

j) vlerëson mundësinë e aksionarëve të propozuar të bankës ose aftësinë e bankës së huaj për të injektuar kapital shtesë, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të përballuar rreziqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare;

k) vlerëson strukturën organizative të bankës ose degës së bankës së huaj të propozuar, në mënyrë që struktura e drejtimit dhe menaxhimit, si dhe sistemi i kontrollit të brendshëm të sigurojnë administrimin efektiv dhe të kujdesshëm të mjeteve dhe burimeve, dhe të mos pengojnë mbikëqyrjen efektive të saj;

l) vlerëson dhe verifikon opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

m) vlerëson gatishmërinë e aksionarëve të propozuar ose të bankës së huaj, për t'iu përgjigjur kërkesave dhe detyrimeve për mbikëqyrjen në vazhdimësi të bankës ose degës së bankës së huaj të propozuar;

n) në rastin e degës ose filialit të bankës së huaj, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me bankën mëmë, lidhur me dërgimin nga kjo e fundit të informacionit periodik për gjendjen financiare të bankës së huaj, për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar.

5. Në rastin e degës së bankës së huaj, përveç sa është parashikuar në pikën 4 të këtij neni, Banka e Shqipërisë shqyrton dhe bën një analizë të:

a) kushteve ekonomike dhe politike të vendit të origjinës;

b) tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit të origjinës dhe pozicionit në treg të bankës së huaj;

c) skemës së mbikëqyrjes bankare në vendin e origjinës, si dhe aftësisë së autoritetit të mbikëqyrjes bankare në këtë vend, për përmbushjen e këtij funksioni;

d) legjislacionit dhe praktikave të kontabilitetit që zbatohen në vendin e origjinës.

6. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe

dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, Drejtorinë e Tatim Taksave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës etj.

Neni 9

Miratimi paraprak i licencës ose refuzimi i saj

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për licencë, kur krijon bindjen se:
 - a) janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 19 të ligjit për bankat;
 - b) janë plotësuar kërkesat e pikave 4 dhe 5 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
 - c) janë vlerësuar rreziqet shtesë si rezultat i strukturës së pronësisë të grupit ku do të bëjë pjesë banka ose dega e bankës së huaj, veçanërisht në marrëdhëniet me elementet jobankare të tij; dhe
 - d) nga analiza e të dhënave të biznesplanit për 3 (tri) vitet e para, rezulton se banka ose dega e bankës së huaj e propozuar do të respektojë normat mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë kërkon ndryshimin e emrit të propozuar për bankën që parashikohet të licencohet, në rast se çmon që ky i fundit mund të krijojë konfuzion në publik ose në sistemin bankar.
3. Banka e Shqipërisë njofton me shkrim personin aplikues për dhënien ose refuzimin e miratimit paraprak për licencë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit përkatës.

Neni 10

Informacion për faktet e reja

1. Personi aplikues për licencë njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë për faktet ose rrethanat e reja të konstatuara pas dhënies së miratimit paraprak për licencë, si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentacionin e paraqitur, mbi bazën e të cilit Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimin paraprak për licencë.
2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas ndodhjes ose vënies në dijeni të personit për faktet ose rrethanat e reja.

Neni 11

Licenca

1. Pas dhënies së miratimit paraprak për licencë, personi kërkon me shkrim në Bankën e Shqipërisë dhënien e licencës, duke paraqitur edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) dokumentin bankar që vërteton pagimin e shumës së kapitalit fillestar minimal apo për transferimin e shumës së kapitalit fillestar të dhuruar të degës së bankës së huaj sipas kushteve të përcaktuara në nenin 18, pika 2 të ligjit për bankat;
 - b) aktin e regjistrimit fillestar të bankës si person juridik ose të regjistrimit të degës së bankës së huaj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
 - c) statutin e bankës dhe aktin e themelimit;
 - d) aktet e brendshme (politikat, procedurat dhe rregulloret e brendshme) të miratuara nga organet drejtuese të bankës ose të bankës së huaj. Këto akte kanë për objekt rregullimi veprimtaritë kryesore që do të zhvillojë banka e re ose dega e bankës së huaj, politikat për administrimin dhe kontrollin e kredidhënies, politikat lidhur me vlerësimin, rishikimin, administrimin, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve dhe ekspozimeve të mëdha, si dhe mënyrën e krijimit të fondeve rezervë për humbjet nga kreditë;
 - e) vendimin e organeve drejtuese të bankës apo të organeve përkatëse të bankës së huaj në rastin e degës së bankës së huaj, për marrjen në punë të administratorëve. Këtyre vendimeve u bashkëngjitet një përshkrim i shkurtër i kompetencave të administratorëve, së bashku me specimenet dhe me të drejtat e nënshkrimit për secilin prej tyre;
 - f) aktin juridik për fitimin e të drejtës së përdorimit të ambienteve ku do të zhvillohet veprimtaria bankare dhe financiare;
 - g) vendimin e asamblesë së aksionarëve të bankës ose organit përkatës të bankës mëmë për degën e bankës së huaj për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në përputhje me kërkesat e rregullores “Për ekspertët kontabël të autorizuar”. Ky vendim shoqërohet me të dhëna për numrin, datën e licencës së ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe për autoritetin ligjor që e ka lëshuar;
 - h) kontratat përkatëse lidhur me sigurimin nga rreziqet kryesore (zjarri, tërmeti etj.) të ambienteve dhe pajisjeve me shoqëritë e sigurimit;
 - i) kontratat për mbrojtjen e ambienteve dhe pajisjeve nga shoqëritë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike;
 - j) një vërtetim mbi marrjen e masave për sigurimin nga zjarri të ambienteve të bankës, të lëshuar nga organet kompetente;

k) vërtetim i lëshuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave;

l) vërtetim për pagimin e komisionit të dhënies së licencës;

m) dokumentacionin për anëtarët e këshillit drejtues, komitetin e kontrollit dhe administratorë të tjerë lidhur me arsimimin, përvojën profesionale dhe reputacionin e tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit për bankat dhe aktet rregullative të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

2. Banka e Shqipërisë, përpara miratimit të licencës kryen një inspektim në vend, të kushteve teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat subjekti do të zhvillojë veprimtarinë. Qëllimi i këtij inspektimi është të vlerësojë nëse subjekti ka krijuar kushte për respektimin e detyrimeve të përcaktuara me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë, lidhur me kushtet teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat subjekti do të zhvillojë veprimtarinë.

Neni 12 Komisionet

Banka ose dega e bankës së huaj, për efekt të përpunimit të kërkesës për licencë, dhënies së licencës dhe ushtrimit të veprimtarisë së saj, paguan në Bankën e Shqipërisë komisionet e mëposhtme:

- | | |
|--|-------------------------------|
| a) për përpunimin e kërkesës për licencë | 300.000 (treqind mijë) lekë; |
| b) për dhënien e licencës..... | 200.000 (dyqind mijë) lekë; |
| c) për vlefshmërinë e licencës..... | 50.000 (pesëdhjetë mijë)lekë. |

KREU III VEPRIMTARITË SHITESË

Neni 13 Dokumentacioni i kërkuar për veprimtaritë shtesë

Banka ose dega e bankës së huaj, e cila pas licencimit kërkon të ushtrojë veprimtari shtesë të papërfshira në aneksin e licencës së saj, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e organit përkatës vendimmarrës të bankës ose të bankës së huaj në rastin e degës së bankës së huaj, për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë shtesë;

b) projektin e ndryshuar të statutit, nëse statuti përmban një dispozitë që përcakton objektin e veprimtarisë;

c) planbiznesin/parashikimet e bankës ose të degës së bankës së huaj për tri vitet e ardhshme lidhur me veprimtarinë shtesë. Ky dokument duhet të përshkruajë efektin e parashikuar mbi gjendjen financiare të bankës ose të degës së bankës së huaj, që rrjedh nga veprimtaria shtesë që kërkohet të ushtrohet, si dhe vlerësimin e rreziqeve që ndërmerr banka ose dega e bankës së huaj, gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie, në mënyrë që këto rreziqe të jenë brenda kufizimeve të vendosura në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë;

d) dokumentacionin që vërteton aftësitë profesionale të punonjësve të bankës ose të degës së bankës së huaj, të cilët parashikohet të kryejnë këto veprimtari;

e) të dhëna që tregojnë plotësimin e kushteve administrative (rregullore, udhëzime, procedura, manuale etj.) dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive financiare shtesë.

KREU IV ZGJERIMI I RRJETIT BANKAR, MIRATIME PARAPRAKE DHE DETYRIMI PËR NJOFTIM

NËNKREU I ZGJERIMI I RRJETIT BANKAR BRENDË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 14 Hapja e një ose disa agjencive/degëve të reja

1. Banka ose dega e bankës së huaj, e cila kërkon të zgjerojë rrjetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, paraqet një kërkesë me shkrim për dhënien e miratimit paraprak nga Banka e

Shqipërisë për këtë qëllim. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e organit kompetent të bankës ose të degës së bankës së huaj, për miratimin e hapjes së degës/ve ose agjencisë/ve;

b) të dhëna për vendndodhjen dhe zonën e propozuar të ushtrimit të veprimtarisë së degës ose të agjencisë;

c) një kopje të aktit të brendshëm rregullativ të organizimit të degës ose agjencisë së re të propozuar, e cila përcakton funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe llojet e veprimtarive bankare dhe/ose financiare që do të kryhen nga kjo e fundit;

d) një përshkrim të shkurtër të kompetencave të drejtuesit/ve kryesorë të degës apo agjencisë;

e) planin e biznesit të degës ose agjencisë, i cili duhet të pasqyrojë në mënyrë të veçantë parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancin kontabël dhe *cash flow*-n për tri vitet e para të veprimtarisë së degës apo agjencisë.

2. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me dhënien e miratimit paraprak për zgjerimin e rrjetit bankar do të kryhet në dy faza. Në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për zgjerimin e rrjetit, kur pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur krijon bindjen se:

a) Për bankat:

I. Kapitali bazë i bankës, si rezultat i hapjes së degës ose agjencisë, nuk do të bjerë nën nivelin e shumës së kapitalit fillestar minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë.

II. Gjendja financiare e bankës, që ushtron veprimtari bankare dhe financiare në Shqipëri, është vlerësuar në ose mbi nivelin mesatar sipas klasifikimit “CAMELS” ose “CAELS” më të fundit.

III. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës, pas kryerjes së zgjerimit, nuk bie nën nivelin minimal të kërkuar.

IV. Ky zgjerim nuk vë në rrezik pozitën financiare, mbikëqyrëse apo vazhdimësinë operacionale të bankës.

b) Për degën e bankës së huaj:

I. Nuk vihen në rrezik respektimi i niveleve të kërkuara të rrezikut sipas rregullores në fuqi “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”.

II. Ecuria ekonomike/financiare pas zgjerimit parashikohet të jetë e kënaqshme, mbështetur në planbiznesin për tri vitet e para të veprimtarisë së degës ose agjencisë së re.

III. Zgjerimi nuk kërcënon pozitën mbikëqyrëse të bankës lidhur me kërkesat organizative dhe treguesit financiarë apo

IV. Struktura e tregut bankar dhe/ose financiar si rezultat i zgjerimit nuk cenon parimin e konkurrencës.

3. Banka ose dega e bankës së huaj, së cilës i është komunikuar moskundërshtimi i Bankës së Shqipërisë për zgjerimin e rrjetit bankar, ka të drejtë të fillojë ndërmarrjen e veprimeve përgatitore për plotësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të kërkuar në fazën e dytë të kësaj procedure.

4. Banka ose dega e bankës së huaj, për efekt të zbatimit të pikës 3 të këtij neni, duhet të ketë paraqitur në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e plotë të kërkuar në fazën e dytë të kësaj procedure brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e marrjes së njoftimit për moskundërshtimin e Bankës së Shqipërisë për zgjerimin e rrjetit bankar. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, banka ose dega e bankës së huaj detyrohet të riparaqesë në Bankën e Shqipërisë kërkesën për dhënien e miratimit paraprak për zgjerimin e rrjetit bankar, mbi bazën e të cilës do të rifillojë një procedurë e re për këtë qëllim.

5. Në fazën e dytë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për zgjerimin e rrjetit të bankës. Ky miratim jepet vetëm pas plotësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

a) të kontratës për sigurimin e ambienteve dhe të pajisjeve me shoqëritë e sigurimit;

b) të kontratave për mbrojtjen e ambienteve e të pajisjeve me shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike;

c) të vërtetimit mbi sigurimin nga zjarri të ambienteve të agjencisë apo degës, të lëshuar nga organet kompetente për parandalimin e zjarreve;

d) të aktit juridik, në bazë të së cilit subjekti ka përfutur të drejtën për përdorimin e ambienteve ku do të kryhet veprimtaria bankare dhe financiare nga agjencia apo dega;

e) të adresës së saktë të degës apo agjencisë së re; dhe

f) të njoftimit me shkrim nga banka apo dega e bankës së huaj për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për kryerjen e veprimtarisë bankare dhe financiare.

6. Banka ose dega e bankës së huaj lejohet të fillojë të ushtrojë veprimtarinë bankare dhe

financiare në agjencinë/të apo degën/ët e re/ja vetëm pas marrjes së miratimit paraprak për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë.

7. Banka e Shqipërisë kryen inspektimin në vend lidhur me plotësimin e kushteve të kësaj rregulloreje, edhe pasi dega apo agjencia ka filluar të ushtrojë veprimtaritë bankare dhe financiare.

8. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë të degës/agjencisë dhe/ose të revokojë dhënien e miratimit paraprak për zgjerimin e rrjetit bankar, nëse pas kryerjes së inspektimit në vend konstaton se nuk plotësohen kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare.

Neni 15

Kërkesa për miratim paraprak për zyrë përfaqësimi

1. Banka e huaj që kërkon të hapë zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, merr miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për hapjen në Republikën e Shqipërisë të zyrës së përfaqësimit të bankës së huaj, pasi shqyrton dokumentacionin e përcaktuar nga shkronja “a” deri në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 17 të ligjit për bankat, si dhe dokumentacionin vijues:

a) vendimin e organit kompetent të bankës së huaj për hapjen e një zyre përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë;

b) deklaratën e bankës së huaj, me anë të së cilës kjo e fundit angazhohet se do të zbatojë të gjitha detyrimet e rrjedhura/krijuara në Republikën e Shqipërisë në lidhje me veprimtarinë e zyrës së përfaqësimit;

c) qëllimin e hapjes së saj;

d) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë, adresën e saj dhe numrin e telefonit;

e) emrat e personave të propozuar për drejtues të zyrës së përfaqësimit të shoqëruar me *curriculum vitae* të tyre (arsimimin, profesionin, eksperiencën etj.);

f) numrin e parashikuar të punonjësve të zyrës;

g) aktin e regjistrimit të zyrës së përfaqësimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

h) lejen nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës për hapjen e zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Zyra e përfaqësimit të një banke të huaj regjistrohet dhe përdor të njëjtin emër me atë të bankës mëmë, duke shtuar fjalët “zyrë përfaqësimi”.

4. Zyra e përfaqësimit mund të kryejë funksione të përfaqësimit dhe/ose administrative, promocionale apo kërkime në treg në funksion të veprimtarisë që ushtron banka e huaj, apo që kjo e fundit parashikon të ushtrojë në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë. Zyra e përfaqësimit nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie bankare dhe/ose financiare, apo veprimtari tjetër tregtare.

5. Banka e Shqipërisë refuzon kërkesën për hapjen e zyrës së përfaqësimit ose revokon vendimin për miratimin e hapjes së saj nëse:

a) ekzistojnë të dhëna serioze dhe të besueshme se banka ose zyra e përfaqësimit është në ndonjë mënyrë e lidhur me veprimtari terroriste, të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, të krimit financiar ose ekonomik etj., ose nëse është provuar përfshirja në një veprimtari të tillë;

b) bankës së huaj i është revokuar licenca;

c) miratimi është bërë duke u bazuar në dokumentacion të pavërtetë ose të pasaktë.

6. Zyra e përfaqësimit paraqet në Bankën e Shqipërisë informacion të përditësuar mbi çdo ndryshim në të dhënat e saj kryesore të paraqitura gjatë procedurës së dhënies së miratimit për hapjen e saj. Zyra e përfaqësimit paraqet gjithashtu në çdo fund viti në Bankën e Shqipërisë një raport vjetor, i cili përmban informacionin e plotë për veprimtarinë e kryer dhe ndryshimet në personelin e zyrës.

NËNKREU II

ZGJERIMI I RRJETIT BANKAR JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 16

Hapja e degës, filialit, agjencisë ose zyrës së përfaqësimit

1. Banka, për të hapur degë, filial, agjenci ose zyrë përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i paraqet një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për hapjen e një dege, agjencie ose zyre përfaqësimi:

i) vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së

Shqipërisë;

ii) vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë, sipas rastit nga dega, agjencia ose zyra e përfaqësimit e propozuar;

iii) një kopje të rregulloreve të degës, të agjencisë ose të zyrës së përfaqësimit të propozuar, ku të përcaktohen veprimtaritë që do të ushtrohen;

iv) planbiznesin për degën ose agjencinë për tre vitet e para të veprimtarisë;

v) shumën e kapitalit për t'u investuar jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës, si dhe shpenzimet e tjera operative;

vi) informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës, agjencisë ose zyrës së përfaqësimit, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;

vii) parashikimin, nga ana e bankës, të rezultatit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;

viii) strukturën organizative të degës/agjencisë, së bashku me numrin e punonjësve të propozuar;

ix) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimtarisë së zyrës së përfaqësimit;

x) emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e bankës;

xi) informacion për skemën e sigurimit të depozitave në vendin ku do të hapet dega;

b) Për hapjen e një filiali, përveç kërkesave “i”, “ii”, “iii” dhe “v” të shkronjës “a” të këtij neni, duhet paraqitur dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

i) planbiznesi i filialit dhe parashikimi për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të bankës, për tre vitet e para të aktivitetit;

ii) informacion për dy administratorët kryesorë të filialit;

iii) informacion për identitetin, vendqëndrimin/rezidencën ose selinë si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në filial;

iv) veprimtaritë bankare dhe financiare që filiali parashikon të kryejë.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për realizimin e zgjerimit të bankës jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm kur krijon bindjen se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur sipas germës “a” ose “b” të pikës 1 të këtij neni janë plotësuar kriteret e pikës 2 të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

3. Degët e bankave që hapen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kryejnë vetëm ato veprimtari të përcaktuara në aneksin e licencës së bankës mëmë.

NËNKREU III

MIRATIME TË TJERA PARAPRAKE

Neni 17

Ndryshimi i pjesëmarrjes influencuese

1. Banka e Shqipërisë miraton ndryshimet (blerjen, shitjen ose transferimin) e pjesëmarrjes influencuese të një banke, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 24, pika 1, germat “gj” dhe “h”, dhe në nenin 25 të ligjit për bankat.

2. Personi i cili kërkon të zotërojë pjesëmarrje influencuese në një bankë, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të shoqëruar me vendimin e asamblesë së aksionarëve të bankës, për miratimin e këtij ndryshimi;

b) dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, paragrafi 1, shkronjat “b”, “c” dhe “d” të kësaj rregulloreje;

c) në rastin dhe kur si pasojë e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese, në kapitalin aksionar të bankës përfshihet një aksionar i ri, ky i fundit duhet të paraqesë deklaratën noteriale me të cilën ai angazhohet se do të ruajë interesat e klientëve të bankës;

d) kopjen e marrëveshjes/kontratës së nënshkruar ose të aktit juridik për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese;

e) në rastin kur personi që kërkon zotërimin ose ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese është një bankë e huaj, do të paraqitet dokumentacioni sipas kërkesave të shkronjave “a” deri “d” të këtij neni;

f) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të fondeve që do të përdoren për pagesën e kapitalit të bankës dhe shlyerjen e detyrimeve të mundshme tatimore për këto të fundit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 13 të ligjit “Për bankat”;

g) pëlqimin e autoritetit mbikëqyrës të vendit të origjinës për zotërimin e kësaj pjesëmarrjeje

influcuese (nëse është i aplikueshëm).

3. Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, Banka e Shqipërisë publikon njoftimin për kërkesën e paraqitur për ndryshimin në pjesëmarrjen/t influencuese të bankës.

4. Banka e Shqipërisë, për të vlerësuar dhe gjykuar përmbushjen e kërkesave të këtij neni, përveç dokumentacionit të administruar, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, Drejtorinë e Tatim Taksave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës etj.

5. Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon zotërimin apo ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të aksioneve të bankës jo më vonë se (3) muaj nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

Neni 18

Kërkesa për dokumentacionin në lidhje me miratime të tjera paraprahe

1. Banka mund të ndryshojë emrin e saj vetëm pas miratimit paraprahe me shkrim nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë kërkesën përkatëse të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për ndryshimin e emrit të bankës;
- b) një relacion shoqërues me përmbajtjen dhe arsyet e këtij ndryshimi.

2. Banka mund të ndryshojë statutin vetëm pas miratimit paraprahe me shkrim nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë kërkesën përkatëse të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për ndryshimin e statudit;
- b) projektstatutin ose projektin e neneve të statudit që propozohen për t'u ndryshuar; dhe
- c) një relacion shoqërues me përmbajtjen dhe arsyet e këtij ndryshimi.

3. Në rastin kur ndryshimet në statutin e bankës janë të lidhura me rritjen e kapitalit të saj me mjete likuide, kërkesa përkatëse paraqitet në Bankën e Shqipërisë, e cila jep miratimin për këtë qëllim, pasi të jetë realizuar zmadhimi i kapitalit.

4. Banka mund të zvogëlojë kapitalin vetëm pas miratimit paraprahe me shkrim të Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë kërkesën përkatëse të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për zvogëlimin e kapitalit;
- b) një relacion shoqërues për ndryshimin që shpjegon arsyet e këtij ndryshimi;
- c) efektet financiare të zvogëlimit të kapitalit në gjendjen financiare të bankës (bilanci kontabël, pasqyrat financiare etj.), të shoqëruara me opinionin e ekspertit kontabël të autorizuar.

5. Banka mund të shpërndajë kapitalin vetëm pas miratimit paraprahe me shkrim të Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast banka paraqet në Bankën e Shqipërisë:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për shpërndarjen e kapitalit;
- b) një relacion shoqërues për shpërndarjen e aksioneve dhe arsyet e kësaj shpërndarjeje;
- c) marrëveshjet midis aksionarëve dhe/ose palëve të treta për shpërndarjen e aksioneve;
- d) efektet financiare të shpërndarjes së kapitalit në gjendjen financiare të bankës (bilanci kontabël, pasqyrat financiare etj.), të shoqëruara me opinionin e ekspertit kontabël të autorizuar.

6. Banka mund të zmadhojë kapitalin me mjete jolikuide vetëm me miratimin paraprahe të Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për zmadhimin e kapitalit;
- b) relacionin shoqërues me masën e ndryshimit, mënyrën dhe arsyet e këtij ndryshimi;
- c) një deklaratë të aksionarëve se kapitali jolikuide nuk do të jetë pjesë e kapitalit rregullator të bankës për qëllime të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- d) raportin e vlerësimit të mjetit/ve jolikuide nga një vlerësues i licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

7. Banka mund të riblejë aksionet e saj ose të personave të lidhur me të, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një personi tjetër, duke dhënë kredi ose duke lëshuar garanci, vetëm me miratimin paraprahe të Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë:

- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për riblerjen e aksioneve;
- b) relacionin shoqërues me përmbajtjen e ndryshimit dhe arsyet e këtij ndryshimi;
- c) marrëveshjet respektive të lidhura me palë të treta për kredinë/të dhe/apo garancinë/të për riblerjen e aksioneve.

8. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

NËNKREU IV DETYRIMI PËR NJOFTIM

Neni 19

Kërkesa mbi detyrimet për njoftim

1. Banka njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për zmadhimin e kapitalit me mjete likuide. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për zmadhimin e kapitalit;
b) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit e shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 13 të ligjit për bankat.

2. Banka njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për ndryshimet në strukturën e kapitalit. Në këtë rast banka paraqet në Bankën e Shqipërisë:

a) aktin për veprimin juridik përkatës (kontratë shitblerjeje, testament) që sjell më pas ndryshimet në strukturën e kapitalit;

b) vendimin e organit drejtues të bankës për dhënien e pëlqimit për kalimin e pronësisë të aksioneve (nëse është e aplikueshme);

c) relacionin shoqërues për ndryshimet në strukturën e kapitalit;

d) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit e shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 13 të ligjit për bankat.

3. Banka njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për ndryshimin e selisë (zyrave të drejtorisë qendrore) dhe/ose vendit/adresës së ushtrimit të aktivitetit të degëve ose agjencive të saj.

4. Banka e Shqipërisë, pas njoftimit të marrë për ndryshimin e vendit/adresës së ushtrimit të aktivitetit të degëve ose agjencive të bankës, mund të realizojë një inspektim në vend mbi plotësueshmërinë e kërkesave të pikës 5 të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

KREU V RIORGANIZIMI I BANKËS

NËNKREU I BASHKIMI

Neni 20

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për bashkimin me përthithje

1. Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me përthithje pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga banka përthithëse dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionarëve të secilës bankë të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me përthithje;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të bashkimit me përthithje, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të bankave që marrin pjesë në bashkim. Marrëveshja dhe raporti hartohen me shkrim dhe në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm;

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projektmarëveshjes së bashkimit;

d) projektstatuti i bankës pas realizimit të operacionit të bashkimit me përthithje;

e) planet strategjike dhe operative për realizimin e përthithjes, në të cilat përfshihet analiza e nevojshmërisë së përthithjes dhe parashikime të raporteve financiare për bankën përthithëse, të përgatitura në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, shkronja “e” të kësaj rregulloreje;

f) nëse do të ketë ndryshime në strukturën organizative të bankës përthithëse, struktura e re organizative me përshkrim të veçantë të punës dhe të përgjegjësisë të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta si dhe numri i mundshëm i punonjësve;

g) nëse ka ndryshime në administratorët e bankës përthithëse, për këta do të paraqitet dokumentacioni sipas kërkesave të përcaktuara për administratorët në ligjin “Për bankat” si dhe në aktet

nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

h) struktura e re e aksionarëve të bankës përthithëse, duke përfshirë aksionarët e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;

i) bilanci i bankës përthithëse dhe të dhëna të detajuara për kapitalin aksionar të vet, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

Neni 21

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për bashkimin me krijim

1. Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me krijim pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga bankat ekzistuese dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionarëve të secilës bankë të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me krijim;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të bashkimit i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të bankave që bashkohen, të cilët duhet të përmbushin kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm;

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit;

d) bilanci i bankës së re me të dhëna të detajuara për kapitalin aksionar të vet, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

NËNKREU II

NDARJA

Neni 22

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për ndarjen me krijim

1. Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet ndarjes me krijim pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga banka që po ndahet dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionarëve të bankës që po ndahet për miratimin e operacionit të riorganizimit nëpërmjet ndarjes me krijim;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të ndarjes, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të bankave të përfshira në këtë operacion, i cili përgatitet në përputhje me kërkesat e përshtuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm;

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së ndarjes;

d) bilancet e bankave të reja pritëse me të dhëna të detajuara mbi kapitalin aksionar;

e) nëse kapitali i bankës që ndahet nuk plotëson minimumin e kapitalit fillestar të kërkuar për bankat pritëse, që përfitohen nga procesi i ndarjes, depozitohen fonde të nevojshme shtesë në Bankën e Shqipërisë në një llogari depozitë.

Neni 23

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për ndarjen me përthithje

1. Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet ndarjes me përthithje pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga banka që ndahet dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionarëve të secilës bankë të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet ndarjes me përthithje;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të ndarjes, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të bankave të përfshira në këtë operacion, të cilët përgatiten në përputhje me kërkesat e përshtuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm;

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së ndarjes;

d) plani strategjik dhe operacional për realizimin e ndarjes, i cili përfshin analizat e nevojshmërisë së ndarjes dhe parashikime të raporteve financiare, të përgatitura për bankën që ndahet dhe për bankat pritëse;

e) struktura e re organizative e bankave pritëse me përshkrim të veçantë të punës dhe të përgjegjësi të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe numri i mundshëm i punonjësve;

f) bilancet e bankës që ndahet dhe të bankave pritëse me të dhëna të detajuara të kapitalit aksionar të vet. Bilancet përgatiten mbi baza të konsoliduara dhe certifikohen nga një ekspert kontabël i autorizuar;

g) struktura e re e aksionarëve të bankave pritëse, duke përfshirë aksionarët e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, nëse pas ndarjes ka ndryshime në strukturën e aksionarëve të bankave;

h) të dhënat e përcaktuara në nenin 7, pika 1, germa, “e” të kësaj rregulloreje për biznesplanin e bankave pritëse.

Neni 24

Të përgjithshme për bashkimin dhe ndarjen

1. Në rastet kur bashkimet dhe ndarjet çojnë në krijimin e të paktën një banke të re, kjo e fundit do t’u nënshtrohet të gjitha rregullave për licencimin rishtazi si e tillë, në bazë të ligjit për bankat dhe të kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së kërkesës për miratimin e bashkimit/ndarjes, publikon njoftimin përkatës për kërkesën e paraqitur nga ana e bankës.

3. Banka e Shqipërisë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë rregullore, mund të kërkojë rast pas rasti dhe informacione të tjera shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme në procesin e vendimmarrjes nisur nga veçoritë (specifikat) e këtij procesi.

4. Banka e Shqipërisë, pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur, merr vendimin për miratimin ose refuzimin e riorganizimit të bankës.

5. Banka e Shqipërisë miraton ato bashkime/ndarje, që përveç sa përcaktohet në këtë rregullore, nuk shkelin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e konkurrencës në tregun bankar dhe nuk rrezikojnë pozicionin e depozituesve.

6. Afati maksimal për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose për refuzimin e bashkimit/ndarjes, është tre muaj nga depozitimi i dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

7. Në rastin e bashkimit me përthithje, banka përthithëse vazhdon të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat ajo është licencuar.

8. Në rastin e ndarjes me përthithje banka/t pritëse vazhdon/jnë të ushtrojnë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat ajo është licencuar.

9. Në rastet e veçanta të bashkimit me përthithje të parashikuara në nenin 225 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dokumentacioni i kërkuar për miratimin e riorganizimit do të jetë në përputhje me përcaktimet e këtij neni.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Masat ndëshkimore dhe mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Neni 26

Dispozita tranzitore

Kjo rregullore do të zbatohet vetëm për procedurat e nisura pas hyrjes në fuqi të saj. Si datë e fillimit të procedurave do të konsiderohet data e regjistrimit të kërkesës apo njoftimit përkatës në Bankën e Shqipërisë.

Neni 27
Dispozita përfundimtare

Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

Formulari nr.1

KËRKESË
PËR
BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TË DHËNË LICENCË
PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE
NË MBËSHTETJE TË NENIT 19 TË LIGJIT NR.9662, DATË 18.12.2006
“PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Emri i bankës së propozuar

Banka: _____

(Vendndodhje e propozuar: adresa)

(Qyteti)

(Rrethi)

_____, Shqipëri

Me anë të kësaj kërkesë, i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionin shqiptar.

Bankën e propozuar mendojmë ta emërtojmë si më sipër, pasi

Kërkuesit

P.s. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj

rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", nr.1
Tiranë, Shqipëri.

Formulari nr.1 (vazhdim)

VENDIMI
I KËSHILLIT DREJTUES
PËR CAKTIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT

Këshilli drejtues i propozuar vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, këshilli drejtues i propozuar emëron dhe përcakton si person kontakti:

(Emri) (Atësia) (Mbiemri)

Adresa: _____
(Rruga, numri) (Qyteti) (Shteti)

(Numri i faksit/teleksit) (Numri i telefonit) -----

(Adresa e postës elektronike)

Personi i kontaktit është i autorizuar të përfaqësojë bankën e propozuar dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e këshillit drejtues. Personi i kontaktit është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë.

Personi i kontaktit i emëruar mund të ndryshohet me rezolutë të pranuar nga pjesa më e madhe e nënshkruesve, rezolutë e cila do të vërtetohet në Bankën e Shqipërisë nga nënshkruesit që votojnë për të njëjtën gjë.

Datë _____,

(Emri,mbiemri) i anëtarëve të këshillit

(Nënshkrimi)_____

Shënim. Ky formular vërtetohet nga noteri.

KËRKESË
PËR BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME RIORGANIZIMIN E BANKËS

Lloji i riorganizimit:

- ☐ Bashkim me përthithje
- ☐ Bashkim me krijim
- ☐ Ndarje me krijim
- ☐ Ndarje me përthithje
- ☐ Emri i bankës së përthithur / që bashkohen
- ☐ Emri i bankës që ndahet

Banka: _____

(Adresa)

Banka: _____

(Adresa)

Shqipëri (Qyteti) (Rrethi)

Shqipëri (Qyteti) (Rrethi)

- ☐ Emri i bankës përthithëse/ që krijohet
- ☐ Emri i bankave pritëse

Banka: _____

(Adresa)

Banka: _____

(Adresa)

Shqipëri (Qyteti) (Rrethi)

Shqipëri (Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të miratuar riorganizimin e bankës/ave.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionin shqiptar.

Bankën e propozuar mendojmë ta emërtojmë si më sipër, pasi

Kërkuesit

P.s.Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj

rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1
Tiranë, Shqipëri.

Formulari nr.2

**NJOFTIM PËR SHTYP I APLIKIMIT
TË PARAQITUR NË BANKËN E SHQIPËRISË
PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI
BANKARE DHE FINANCIARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Aplikantët (emrat e personave)

1. _____ adresa _____
2. _____ adresa _____
3. _____ adresa _____
4. _____ etj. _____

Ne kemi qëllim të krijojmë së bashku një bankë, për këtë kemi paraqitur një kërkesë në Bankën e Shqipërisë për të marrë licencë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Bankës së Shqipërisë i është vënë në dispozicion dokumentacioni lidhur me reputacionin, me aktivitetin, me eksperiencën dhe me të dhënat lidhur me projektet që ne kemi në kryerjen e aktivitetit bankar.

Banka e Shqipërisë, për marrjen e vendimit të saj, merr në konsideratë një numër faktorësh, ndër të cilët edhe nëse banka e propozuar do të plotësojë nevojat e komunitetit për kredi.

Ne ju ftojmë të paraqisni komentet tuaja për këtë aplikim, me shkrim, duke iu adresuar:

Bankës së Shqipërisë
Departamenti i Mbikëqyrjes
Sektori i Licencimit, Rregullimit dhe Standardeve
Sheshi "Skënderbej", nr.1 Tiranë.

Banka e Shqipërisë është e interesuar të dijë opinionin tuaj dhe do ta marrë në konsideratë çdo koment tuajin për këtë aplikim.

Dita e botimit

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Emri i bankës së propozuar _____

2. Vendndodhja e bankës së propozuar _____

3. Ndarja e propozuar e kapitalit të nënshkruar:

Kapitali aksionar: (Vlera nominale në lekë

Numri i aksioneve të emetuara që në çelje: _____

4. Këshilli drejtues i bankës (i propozuar):

(Emër, mbiemër)

(Qyteti/ shteti)

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

5. Drejtuesit ekzekutiv të propozuar të bankës:

Emri, mbiemri:

Adresa: qyteti/shteti/posta elektronike

Punësimi aktual:

President/drejtor i përgjithshëm:

Asistenti i drejtorit të përgjithshëm:

Formulari nr.3 (vazhdim)

6. Të dhëna për aksionarët kryesorë dhe për administratorët e bankës që kanë pjesëmarrje influencuese (zotërojnë 10 për qind ose më shumë të kapitalit).

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Adresa e plotë (rruga, qyteti, shteti)	Posta elektronike	Kombësia	Rezidenca : qyteti /shteti

Shënim. Vazhdon në fletë tjetër, në qoftë se është e nevojshme.

LISTA E AKSIONARËVE TË BANKËS

Aksionarë të drejtpërdrejtë	Numri i aksioneve të propozuara	Përqindja e aksioneve të propozuara	Vlera e aksioneve të propozuara

Shënim. Vazhdon në rreshta të tjerë, në qoftë se është e nevojshme.

STRUKTURA E AKSIONARËVE TË BANKËS

Nr.	Emri i aksionarit	Numri i aksioneve	Vlera e aksioneve (në lekë)	Pjesëmarrja direkte në kapitalin e bankës (në përqindje)	Pjesëmarrja indirekte në kapitalin e bankës (në përqindje)	Totali i pjesëmarrjes (në përqindje)
1						
2						
3						

Shënim. Vazhdon në rreshta të tjerë, në qoftë se është e nevojshme.

Formulari nr.6

Ky formular plotësohet nga aksionarët e drejtpërdrejtë që janë persona fizikë tregtarë ose individë.

CURRICULUM VITAE

1. Të dhëna personale

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendlindja:

Shtetësia:

Kombësia:

Adresa e vendbanimit aktual:

Numri social i sigurimit (n.q.s. aplikohet) ____/____/____

Numri i pasaportës:

Vendi ku është lëshuar:

Letra e identifikimit e vendit të tyre:

Gjendja civile: !__! i/e martuar !__! beqar/e !__! i/e divorcuar

Emri i plotë i bashkëshortit:

Emrat e plotë të anëtarëve të familjes:

2. Arsimi i kryer

Ju lutemi filloni nga arsimi i mesëm

1. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	19xx – 19xx
Diploma apo certifikata e fituar	
2. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	19xx – 19xx
Diploma apo certifikata e fituar	

3. Njohja e gjuhëve të huaja

Gjuha e huaj	Njohja në lexim	Njohja në të folur	Njohja në të shkruar

Shënoni vlerësimin me numrat nga 5 – 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.).

4. Pjesëmarrje në këshilla drejtuese/ në shoqata profesionistësh

5. Kurse kualifikimi të kryera

6. Eksperiencia profesionale

Përshkrimi i detajuar i punësimit. Ju lutemi filloni nga punëdhënësi më i fundit

Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a) i punësuar !__! b) i vetëpunësuar !__! c) i papunë !__!

	d) ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (<i>full-time</i>) !__!
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje !__! b) Shkurtimi i vendit të punës !__! c) Dalje në pension !__! d) Përfundimi i kontratës së punësimit !__! e) Pushim nga puna !__! f) Të tjera !__! Specifiko
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a) i punësuar !__! b) i vetëpunësuar !__! c) i papunë !__! d) ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (<i>full-time</i>) !__!
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje !__! b) Shkurtim i vendit të punës !__! c) Dalje në pension !__! d) Përfundimi i kontratës së punësimit !__! e) Pushim nga puna !__! f) Të tjera !__! Specifiko
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a) i punësuar !__! b) i vetëpunësuar !__! c) i papunë !__! d) ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (<i>full-time</i>) !__!

Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyra e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a) Dorëheqje !__! b) Shkurtimi i vendit të punës !__! c) Dalje në pension !__! d) Përfundimi i kontratës së punësimit !__! e) Pushim nga puna !__! f) Të tjera !__! Specifiko

KUNDËRVAJTJET KRIMINALE DHE MASAT DISIPLINORE

7. A keni qenë ndonjëherë i arrestuar, i paditur dhe/ose i dënuar për një kundërvajtje kriminale?

Jo !__!

Po !__!

Në qoftë se Po -Jepni një kopje të ankesës për çështjen dhe për çdo çështje në proces, dhe jepni si më poshtë për të gjitha çështjet në proces dhe të mëparshmet: Emrin dhe adresën e agjencisë së

ngarkuar me zbatimin e ligjit, adresën e vendndodhjes së gjykatës, numrin e dosjes së çështjes, natyrën e dënimit, datën e përmbushjes së dënimit, statusin e çështjes, dispozitën.

Në qoftë se Jo- Jepni një certifikatë lëshuar nga autoritetet e ngarkuara me zbatimin e ligjit, ku të tregohet se ju nuk keni qenë arrestuar, paditur dhe/ose dënuar për kundërvajtje kriminale.

8. A jeni paditur ose dënuar për shmangie ndaj taksave?

Jo !___!

Po !___!

Në qoftë se Po- Jepni hollësi të veçanta që i përkasin kësaj procedure dhe gjobat e ngarkuara.

Në qoftë se Jo- Jepni një certifikatë lëshuar nga organet e tatim-taksave që të tregojë se ju nuk keni qenë paditur ose dënuar për shmangie takse.

9. A jeni të lidhur me ndonjë tregti ose ndërmarrje si zyrtar, drejtor ose pronar i 10 për qind ose më shumë të aksioneve në qarkullim, të paditur ndonjëherë për shkelje kriminale ose që të ketë falimentuar apo punuar jashtë marrëveshjes me kreditorët?

Jo !___!

Po !___!

Në qoftë se Po - Tregoni emrin e biznesit ose të ndërmarrjes, interesin tuaj në këtë biznes, vendndodhjen e gjykatës dhe numrin e dosjes, datën e përmbushjes së dënimit, natyrën e dënimit, statusin e çështjes dhe dispozitën.

INFORMACION I NDRYSHËM

10. Listën e ndonjë biznesi (koorporatë, pjesëmarrje ose ndërmarrje të përbashkët) me të cilën ju jeni lidhur si nëpunës, drejtor, administrator ose pronar, që zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve në qarkullim. Duke përfshirë emrin dhe vendndodhjen e çdo biznesi, natyrën e biznesit, lidhjet tuaja me të, përqindjen e aksioneve në qarkullim që ju zotëroni, në qoftë se zotëroni të tilla dhe datën e krijimit të lidhjes tuaj.

11. Jepni raporte financiare për bizneset e shënuara në pikën 10.

Emri dhe mbiemri i aksionarit të propozuar.

(firma)

Data

BILANCI I PARASHIKUAR I BANKËS
NE MOMENTIN E FILLIMIT TË AKTIVITETIT
(Bilanci kontabël i çeljes së bankës)

Emri i bankës së propozuar: _____

Aktivët
TOTALI I AKTIVEVE
VEPRIMET ME THESARIN DHE NDERBANKARE
Mjete monetare
Marrëdhënie me bankën qendrore
Rezerva të detyrueshme në bankën qendrore
Të tjera
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore
Bono thesari
Bono të tjera të pranueshme për rifinancim
Fonde rezervë për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim nga BQ
Marrëdhënie me bankat, institut. e kreditit dhe instit. tjera financiare
Llogari rrjedhëse
Depozita në banka, institucione krediti dhe inst. tjera financiare
Hua
Të tjera
VEPRIMET ME KLIENTËT
Hua afatshkurtër
Hua afatmesme
Hua afatgjatë
Hua për prona të patundshme
Kontrata qiraje
VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË
Letra me vlerë me të ardhura fikse
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme
Letra me vlerë të blera & shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes
Kolaterali i paguar
Primet e marra
FONDE REZERVË TË KRIJUARA
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (kryegjëja)
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (interesi i përlllogaritur)
Fonde rezervë për investime
MJETE TË TJERA
Mjete të tjera
Veprimet si agjent
Llogari marrëdhëniesh
Llogari pezull, të diferencave dhe të pozicionit
Llogari pezull
Llogari pozicioni
Tatimi i vlerës së shtuar
MJETE TË QËNDRUESHME
Investime në pjesëmarrje
Filialet
Mjete të qëndrueshme (neto)
INTERESA TË PËRLLOGARITURA
Totali i aktiveve në valutë
Totali i aktiveve jorezident
Pasivët
TOTALI I PASIVEVE

VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE
Banka qendrore
Bono thesari & bono të tjera të pranueshme
Llogari rrjedhëse
Depozita nga bankat, inst. financ.
Hua
Të tjera
VEPRIME ME KLIENTËT
Llogari rrjedhëse
Depozita pa afat
Depozita me afat
Certifikata depozitash
Hua
Të tjera
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË
Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë
Letra me vlerë të blera dhe të shitura me REPO
Garanci për veprime me letrat me vlerë
Prime për instrumentet financiare
DETYRIME TË TJERA
Detyrime të tjera
Veprimet si agjent
Llogari marrëdhëniesh
Llogari pezull të diferencave dhe pozicionit
Llogari diferencash
Llogari pozicioni
Tatimi i vlerës së shtuar = (form. 21) 46
BURIMET E PËRHERSHME
Ndihma dhe financimi publik
Fonde rezervë specifike
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime
Fonde rezervë specifike
Borxh i varur
Kapitali i vet i aksionarëve
Kapitali i paguar
Primet e aksioneve
Rezervat
Diferencë rivlerësimi
Fitimet e pashpërndara ose humbja
Fitimi (humbja) i vitit në vazhdim
INTERESA TË PËRLLOGARITURA
Totali i pasiveve në valutë
Totali i pasiveve jorezident

Formulari nr.8

BILANCI I PARASHIKUAR I BANKËS
KJO PARAQITET PËR TRI VITET E PARA TË AKTIVITETIT

Emri i bankës së propozuar: _____

Aktivët

TOTALI I AKTIVEVE	Viti 1	Viti 2	Viti 3
VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE			
Mjete monetare			
Marrëdhënie me bankën qendrore			
Rezerva të detyrueshme në bankën qendrore			
Të tjera			
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore			
Bono thesari			
Bono të tjera të pranueshme për rifinancim			
Fonde rezervë për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim nga BQ			
Marrëdhënie me bankat, institut. e kreditit dhe instit. tjera financiare			
Llogari rrjedhëse			
Depozita në banka, institucione krediti dhe inst. tjera financiare			
Hua			
Të tjera			
VEPRIMET ME KLIENTËT (bruto)			
Hua afatshkurtër			
Hua afatmesme			
Hua afatgjatë			
Hua për prona të patundshme			
Kontrata qiraje			
VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË			
Letra me vlerë me të ardhura fikse			
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme			
Letra me vlerë të blera & shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes			
Kolaterali i paguar			
Primet e marra			
FONDE REZERVË TË KRIJUARA			
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (kryegjëja)			
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (interesi i përllogaritur)			
Fonde rezerve për investime			
MJETE TË TJERA			
Mjete të tjera			
Veprimet si agjent			
Llogari marrëdhëniesh			
Llogari pezull, të diferencave dhe të pozicionit			
Llogari pezull			
Llogari pozicioni			
Tatimi i vlerës së shtuar			
MJETE TË QËNDRUESHME			
Investime në pjesëmarrje			
Filialet			
Mjete të qëndrueshme (neto)			
INTERESA TË PËRLLOGARITURA			
Totali i aktiveve në valutë			
Totali i aktiveve jorezident			
Pasivët			
TOTALI I PASIVEVE			
VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE			
Banka qendrore			
Bono thesari & bono të tjera të pranueshme			
Llogari rrjedhëse			

Depozita nga bankat, inst. Financ.				
Hua				
Të tjera				
VEPRIME ME KLIENTËT				
Llogari rrjedhëse				
Depozita pa afat				
Depozita me afat				
Certifikata depozitash				
Hua				
Të tjera				
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË				
Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë				
Letra me vlerë të blera dhe të shitura me REPO				
Garanci për veprime me letrat me vlerë				
Prime për instrumentet financiare				
DETYRIME TË TJERA				
Detyrime të tjera				
Veprimet si agjent				
Llogari marrëdhëniesh				
Llogari pezull të diferencave dhe pozicionit				
Llogari diferencash				
Llogari pozicioni				
Tatimi i vlerës së shtuar = (form. 21) 46				
BURIMET E PËRHERSHME				
Ndihma dhe financimi publik				
Fonde rezervë specifike				
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime				
Fonde rezervë specifike				
Borxh i varur				
Kapitali i vetë aksionarëve				
Kapitali i paguar				
Primet e aksioneve				
Rezervat				
Diferencë rivlerësimi				
Fitimet e pashpërndara ose humbja				
Fitimi (humbja) i vitit në vazhdim				
INTERESA TË PËRLLOGARITURA				
Totali i pasiveve në valutë				
Totali i pasiveve jorezident				

Formulari nr.9

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE

KJO PARAQITET PËR TRI VITET E PARA TË AKTIVITETIT

Emri i bankës së propozuar: _____

SHPENZIME TË VEPRIMTARISË BANKARE	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Shpenzime për interesa			
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare			
Për veprimet me klientët			
Për borxhe që përfaqësohen nga letrat me vlerë			
Për borxhet e varura			
Për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes			
Të tjera			
Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet financiare			
Humbje nga bonot e thesarit dhe bonot e tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore			
Humbje nga letrat me vlerë të tregtueshme			
Humbje nga letrat me vlerë të vendosjes			
Humbje nga letrat me vlerë të investimit			
Humbje nga veprimet me letrat e tjera me vlerë			
Humbje nga letrat me vlerë të tregtueshme			
Humbje nga letrat me vlerë të vendosjes			
Humbje nga letrat me vlerë të investimit			
Shpenzime të tjera nga veprimet financiare			
Komisione			
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare			
Për transaksionet me klientët			
Për borxhe që përfaqësohen nga letrat me vlerë			
Për borxhet e varura			
Për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes			
Komisione për shërbime bankare			
Komisione të tjera			
Shpenzime për operacionet e qirasë			
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare			
Humbje nga veprimet me valutat			
Shpenzime për personelin			
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat			
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë			
Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme			
Shpenzime amortizimi			
Fonde rezervë			
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme shpenzime për fonde rezervë			
Shpenzime të jashtëzakonshme			
Taksa mbi të ardhurat			
Fitimi i vitit në vazhdim			
TOTALI I SHPENZIMEVE			
Të ardhura të veprimtarisë bankare			
Të ardhura nga interesat			
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare			
Nga veprimet me klientët			
Interesa për letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve të rishitjes			
Të tjera			
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare			
Të ardhura nga bonot e thesarit			
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme			
Të ardhurat nga letrat me vlerë të vendosjes			
Të ardhurat nga letrat me vlerë të investimeve			
Nga veprimet me letrat e tjera me vlerë			
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme			
Të ardhurat nga letrat me vlerë të vendosjes			

Të ardhurat nga letrat me vlerë të investimeve			
Nga interesat pjesëmarrës dhe filialet			
Të tjera			
Komisione për shërbime bankare			
Nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare			
Nga transaksionet me klientët			
Nga borxhet e përfaqësuara prej letrave me vlerë			
Nga borxhet e varura			
Nga letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes			
Komisione për shërbimet bankare			
Komisione të tjera			
Të ardhura nga veprimet e qirasë			
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare			
Fitime nga veprimet me valutat			
Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e mjete të qëndrueshme			
Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar			
Të ardhura të jashtëzakonshme			
Humbja e vitit në vazhdim			
TOTALI I TË ARDHURAVE			

Formulari nr.10

GJENDJA E FONDEVE KAPITALE

PËR TRI VITET E PARA TË AKTIVITETIT

(në lekë)

PËRSHKRIMI	Fundi i vitit të parë	Fundi i vitit të dytë	Fundi i vitit të tretë
Fondet në dispozicion për fillimin e veprimtarisë			

Minus: Shpenzimet e nisjes dhe të organizimit			
Fondet neto të kapitalit në fillim të periudhës			
Të ardhurat (humbjet) neto			
Minus: Dividendët e paguar pronarëve/ aksionarëve			
KAPITALI NË FUND TË PERIUDHËS			

Kapitali në fund të periudhës nuk duhet të jetë më pak se shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar. Nëse vlera e kapitalit në fund të periudhës bien nën vlerën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar, atëherë deklaroni për burimin e shtimit të fondeve.

Formulari nr.11

ADMINISTRATORËT

1. Këshilli i drejtues:

Emri dhe adresa	Detyra	Numri i aksioneve që zotëron*	Përqindja ndaj totalit

TOTALI			

* Në qoftë se zotëron.

2. Komiteti i kontrollit:

Emri adresa dhe pozicioni i propozuar	Detyra	Numri i aksioneve që zotëron	Përqindja ndaj totalit
TOTALI			

3. Drejtoria:

Emri dhe adresa	Detyra	Numri i aksioneve që zotëron	Përqindja ndaj totalit
TOTALI			

4. Është ndonjë nga administratorët e lidhur me ndonjë bankë ose institucion financiar (duke përfshirë çdo institucion tjetër të propozuar) në Shqipëri nëpërmjet punësimit, drejtimit ose pronësisë? Në qoftë se po, përshkruaj në detaje marrëdhënie të tilla dhe komente për plane të individëve për të vazhduar këto marrëdhënie.

5. Përcakto në qoftë se ndonjë nga administratorët e propozuar të këshillit drejtues është zgjedhur ose është emëruar në sektorin publik. Në qoftë se kështu, përshkruaj këtë pozicion dhe përcakto afatin zyrtar.

6. Paraqit informacion biografik dhe financiar, si të zbatueshëm, për çdo anëtar të propozuar të këshillit drejtues dhe për presidentin/drejtorin e përgjithshëm të bankës, dhe për çdo person që

nënshkruan 10 për qind ose më shumë të aksioneve, në formularët e Bankës së Shqipërisë.

Shënim. Informacioni financiar t'i përkojë një periudhe jo më shumë se 6 muaj më parë se data e këtij aplikimi.

7. A janë dhënë shpërblime, kompensime për administratorët ose për drejtorët, ose plane të tilla të ngjashme a janë propozuar? Në qoftë se po, jep një kopje të këtyre planeve.

☐ Kopje e paraqitur

☐ Nuk zbatohet

Formulari nr.12

RAPORTI FINANCIAR PERSONAL SEKRET *

DO TË PLOTËSOHET NGA ÇDO THEMELUES I BANKËS DHE ÇDO NËNSHKRUES ME 10 PËR QIND OSE MË SHUMË TË KAPITALIT AKSIONAR.

GJENDJA FINANCIARE MË _____
(Datë)

Depozituar nga:

Për personat fizikë shënohet: emri, atësia, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, nënshtetësia dhe adresa e vendbanimit.

Për

DEPARTAMENTIN E MBIKËQYRJES
TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në lidhje me:

(Arsyet e veçanta të paraqitjes së këtij raporti)

INSTRUKSIONE:

Shtypni ose printoni këtë raport. Përgjigjuni të gjitha pyetjeve plotësisht. Në qoftë se përgjigjja është “Jo” ose “Asnjë”, ose “E pazbatueshme”, lutemi paraqiteni këtë. Në qoftë se hapësira është e pamjaftueshme, i bashkëlidhni një pasqyrë të veçantë këtij formulari. Informacioni në pasqyrën e veçantë shënohet me numra dhe me germa për t’iu përshtatur këtij formulari dhe të gjitha pasqyrat nënshkruhen dhe të datohen.

Një raport i pasaktë dhe jo i plotë nuk pranohet dhe është shkak për të refuzuar kërkesën për licencë.

Çdo faqe e informacionit në RAPORTIN FINANCIAR PERSONAL SEKRET të nënshkruhet, të datohet nga individë që e plotëson atë dhe të noterohen te një noter publik.

Për të sqaruar ndonjë pyetje në lidhje me këtë RAPORT, personi që e ka plotësuar do të kontaktojë direkt me Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes.

* TË GJITHA TË DHËNAT TË JEPEN NË LEK SHQIPTAR. PËRSHKRUANI METODËN E PËRDORUR NË KËMBIMIN E MONEDHËS DHE SHËNONI KURSIN E KËMBIMIT.

Formulari nr.12 (faqe 2)

GJENDJA E TË ARDHURAVE

TË ARDHURA	200__	200__	200__	Vlera e vitit në vazhdim
Pagat, pagesat dhe kompensimet	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë
Dividendi dhe të ardhurat nga interesat	_____	_____	_____	_____
Të ardhurat neto nga qira dhe investime.	_____	_____	_____	_____
Të ardhura të tjera	_____	_____	_____	_____
TOTALI I TË ARDHURAVE* ZBRITJE	_____	_____	_____	_____
Zbritje dhe rregullime	_____	_____	_____	_____
Taksat për të ardhurat TOTAL I ZBRITJEVE	_____	_____	_____	_____
TË ARDHURAT NETO (Totali i të ardhurave minus zbritjet)	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë	_____ lekë
* Shpjego raste të veçanta për vitin e parë				

Në qoftë se një nga arsyet për të plotësuar këtë raport është përfshirja në blerjen e aksioneve, plotëso informacionin që vijon pas

Shuma e aksioneve të blera	Vlera nominale	Çmimi i blerjes/aksion	Vlera totale blerjes

Përshkruaj mënyrën e pagesës. Në qoftë se mjetet do të jenë likuide për të financuar blerjen, lutemi jepni detaje për këtë

Formulari nr.12 (Faqe 3)

RAPORTI FINANCIAR^a

^a Kjo tabelë do të detajohet në tabelat vijuese

AKTIVET	PASIVET
1. Paraja në dorë dhe në banka _____	7. Pasive korrente të pasiguruara _____
2. Dëftesa, hua dhe llogari të tjera të arkëtueshme të konsideruara të rregullta dhe të mbledhshme _____	8. Pasive korrente të siguruara _____
3. Pronë e patundshme e zotëruar _____	9. Pasive afatgjata të pasiguruara _____
4. Letra me vlerë të tregtueshme _____	10. Pasive afatgjata të siguruara _____
5. Interesa pronare _____	11. Interesi i ardhur dhe taksa për t'u paguar _____
6. Aktive të tjera _____	12. Të tjera pasive dhe detyrime _____
TOTALI I AKTIVEVE _____	TOTALI I PASIVEVE _____
	13. Pasuria neto (aktivet totale minus totalin e pasiveve) _____
	TOTALI I PASIVEVE DHE PASURIA NETO _____

PASIVE TË PASIGURUARA

Përveç detyrimeve dhe pasiveve të shënuara më sipër, unë kam nënshkruar, garantuar ose nga ana tjetër unë jam indirekt ose rastësisht përgjegjës për detyrimet e të tjerëve si më poshtë:

Emri e adresa e debitorit	Emri e adresa e kreditorit	Përshkrimi i kolateralit	Vlera aktuale e kolateralit	Norma e interesit	Data e detyrimit	Teprica aktuale

Formular nr.12 (faqe 4)

PARAJA NË DORË DHE NË BANKA^b
(Vetëm llogaritë personale)

^b Detajim i raportit financiar, pika 1.
2358

EMRI I BANKËS	KODI I LLOGARISË	SHUMA (në lekë)
		Shuma e parasë në banka
		Plus (+) Paraja në dorë
		Mbartur nga pika (1) e raportit financiar
		TOTALI

DËFTESA, HUA DHE DETYRIME TË TJERA TË ARKËTUESHME
TË KONSIDERUARA TË RREGULLTA DHE TË MBLEDHSHME^c

Emri dhe adresa e debitorit	Data e detyrimit	Përshkrimi i kolateralit	Vlera aktuale e kolateralit	Teprica aktuale (në lekë)
			Mbartur nga pika (2) e raportit financiar	
			TOTALI	

Formulari nr.12 (faqe 5)

PRONË E PATUNDSHME E ZOTËRUAR^d

^c Detajim i raportit financiar, pika 2.

^d Detajim i raportit financiar, pika 3.

Përshkrimi dhe vendndodhja	Emri i titullmbajtësit	Data e marrjes	Vlera aktuale e interesit tuaj (në lekë)
Mbartur nga pika (3) e raportit financiar TOTALI			

LETRA ME VLERË TË TREGTUESHME^e
(LISTUAR NË BURSË OSE TREGTOHEN NË TREGTI TË LIRË TË RREGULLT)

Emri i letrës me vlerë	Numri i aksioneve	Përshkrimi (aksione, bono etj.)	Vlera aktuale e tregut (në lekë)
Mbartur nga pika (4) e raportit financiar TOTALI			

Formulari nr.12 (faqe 6)

INTERESAT PRONARE/PERSONAT JURIDIKË PA OFERTË PUBLIKE^f

Poshtë, në kolonat përkatëse, jepni informacionin e kërkuar lidhur me të gjitha bizneset ose ndërmarrjet e ngjashme në të cilat ju zotëroni një interes pronar ligjor ose të drejtë. Shembujt janë: pronësi të vetme, ortakëri, ndërmarrje të përbashkëta dhe person tjetër juridik aksionet e të cilëve nuk

^e Detajim i raportit financiar, pika 4.

^f Detajim i Raportit Financiar, pika 5.

listohen në bursë ose tregtohen në treg të lirë të rregulluar. Në kolonën “Forma e biznesit”, përshkruani formën ligjore të biznesit ose të ndërmarrjes. Në qoftë se ndërmarrja tregtare është një person juridik, përcaktoni natyrën dhe përqindjen e interesit tuaj pronar në biznes ose në ndërmarrje. Në kolonën “Vlera aktuale”, përshkruani vlerën e plotë aktuale në treg të pronësisë suaj.

SHËNIM. Paraqitni të dhënat më të fundit për gjendjen ose të dhëna të tjera të vlerësimit, për të justifikuar vlerat e dhëna në tabelë të cilat përfaqësojnë një sasi të barabartë me 10 për qind ose më shumë të pasurisë suaj neto.

Emri dhe adresa e biznesit	Forma e biznesit	Natyra e biznesit	Natyra e interesit tuaj	Vlera aktuale (në lekë)
Mbartur nga pika (5) e raportit financiar TOTALI				

AKTIVE TË TJERA^g

PËRSHKRUANI AKTIVET, BAZAT DHE METODAT E VLERËSIMIT TË TYRE	VLERA AKTUALE (në lekë)
Mbartur nga pika (6) e raportit financiar TOTALI	

Formulari nr.12 (faqe 7)

DETYRIMET AFATSHKURTRA^h

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet prej 500.000 lekësh ose më shumë për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilave u ka ardhur koha e pagimit ose do të paguhet për një vit ose më pak. (Pjesa e detyrimeve afatgjata nuk përfshihet në këtë formular.)

^g Detajim i Raportit Financiar, pika 6.

^h Detajim i raportit financiar pikat, 7 dhe 8.

Emri dhe adresa e kreditorit	Kontrollo nqs është e siguruar	Siguruar nga	Norma e interesit	Data e fillimit të detyrimit	Data e pagimit të detyrimit	Shuma (në lekë)

Mbartur nga pika (7) e raportit financiar TOTALI i detyrimeve të pasiguruara (në lekë)	
Mbartur nga pika (8) e raportit financiar TOTALI i detyrimeve të siguruara (në lekë)	
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA	

DETYRIMET AFATGJATAⁱ

Paraqitni informacionin e kërkuar në lidhje me të gjitha detyrimet për 500,000 lekë ose më shumë për të cilat ju jeni përgjegjës dhe të cilat do të paguhen për një vit ose më shumë.

Emri dhe adresa e kreditorit	Kontrollo n.q.s është e siguruar	Siguruar nga	Norma e interesit	Data e fillimit të detyrimit	Pagesa mujore (në lekë)	Teprica aktuale (në lekë)

Mbartur nga pika (9) e raportit financiar TOTALI i detyrimeve të pasiguruara (në lekë)	
Mbartur nga pika (10) e raportit financiar TOTALI i detyrimeve të siguruara (në lekë)	
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA	

Formulari nr.12 (Faqe 8)

DETYRIME DHE PASIVE TË TJERA^j

Përshkrimi	Data e detyrimit	Shuma (në lekë)

ⁱ Detajim i raportit financiar pikat, 9 dhe 10.

^j Detajim i raportit financiar, pika 12.

	Mbartur nga pika (12) e raportit financiar TOTALI	

CERTIFIKATË/DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu me sa di dhe besoj është i vërtetë dhe i saktë, ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data) _____ (nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

_____ (nënshkrimi përgatitësit)

TITULLI: _____

ADRESA: _____

Betuar dhe nënshkruar nga në këtë ditë _____ të _____, 20 ____.

(Nënshkrimi i noterit publik)
Komisionet e shërbimit:

Formulari nr.12 (faqe 9)

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL (autorizimi plotësohet në dy ekzemplarë në origjinal)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj për qëllime të inspektimit ose kopjimit të tyre në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë _____

Data data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Betuar dhe nënshkruar në praninë time
data _____, 20 _____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

—

Formulari nr.13

LOKALET E BANKËS DHE VENDNDODHJA E SAJ**

1. Lloji i ambienteve ku banka do të zhvillojë aktivitetin e saj bankar dhe financiar do të jetë:

- ☐ vende të përhershme, marrë me qira;
- ☐ vende të përhershme, pronë vetiake;
- ☐ vende të përkohshme.

2. Përshkrimi i lokaleve:

A) përshkrime të ambienteve të brendshme të ndërtesës (duke shprehur sipërfaqen e shfrytëzueshme, të gjitha lehtësitë për nëpunësit dhe përmasat e hapësirës së hollit);

B) përmasat e truallit; përmasat e ndërtesës, numri i kateve etj.;

C) tipi i konstruksionit të ndërtesës (beton, skelet druri, metal etj. me përshkrim tregues).

3. Lokalet e marra me qira:

- A) emri dhe adresa e pronarit, kostoja vjetore e qirasë së bankës;
- B) përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të ndërtesës së marrë.

4. Lokalet në pronësi:

- A) emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së bankës;
- B) kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.

5. Vendet e përkohshme:

- A) vendndodhja e vendeve të përkohshme;
- B) detaje lidhur me vendet e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë;
- C) në qoftë se vendet e përkohshme do të blihen, parashikoni koston, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes;
- D) në qoftë se vendet e përkohshme do të merren me qira, jepni identitetin e qiramarrësit, qiranë mujore, nëse paguhet një qira minimum.

6. Tregoni investimin e propozuar në mobilie, pajisje dhe një përshkrim të sendeve.

** Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.

Formulari nr.14

PLANBIZNESI I BANKËS SË PROPOZUAR

Planibiznesi përcakton qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të bankës. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht, gjatë tre viteve të para të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e bankës kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht për sa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve. Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet pasur kujdes për përgatitjen e planit të biznesit.

Planibiznesi i propozuar përfshin edhe:

1. strukturën organizative të bankës dhe numrin e mundshëm të punonjësve;
2. llojet e veprimtarive bankare dhe financiare që do të kryhen;
3. deklaratat financiare të parashikuara;
4. parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit;
5. madhësinë dhe natyrën e veprimtarisë së bankës së propozuar dhe pozicionin e saj në tregun financiar;
6. arsyen përse aksionari i propozuar dëshiron të krijojë bankën;
7. vlerësimin e aksionarit/aksionarëve të propozuar mbi gjendjen e sistemit bankar shqiptar,

konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;

8. strategjinë e bankës së propozuar, objektivat dhe pozicionin e saj në treg;

9. arsyet përse subjekti beson se banka do të jetë e suksesshme dhe strategjinë e përgjithshme për të arritur këtë sukses, duke përfshirë argumentet kryesore;

10. adresën e zyrave qendrore të bankës, si dhe numrin e degëve dhe agjencive, së bashku me vendet e afatet ku dhe kur banka planifikon t'i hapë ato;

11. parashikimin e gjendjes financiare të bankës së propozuar për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së saj (bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, *cash flow*, plani i amortizimit të shpenzimeve paraoperacionale, plani i shpërndarjes së fitimit ose i mbulimit të humbjeve etj.), duke përfshirë argumentet kryesore të përdorura për këto parashikime;

12. identifikimin e rreziqeve, ndaj të cilave banka do të ekspozohet gjatë zbatimit të planit të biznesit dhe një përshkrim të metodave/mënyrave të administrimit të rrezikut dhe të sistemeve të kontrollit që do të zbatohen nga banka lidhur me ekspozimin ndaj rreziqeve. Subjekti, në hartimin e planbiznesit dhe në llogaritjen e treguesve, konsideron kërkesat e ligjit “Për bankat”, të akteve rregullative të nxjerra në zbatim të tij, si dhe normat e kufijtë e treguesve të përcaktuar në këtë akte;

vërtetimin për pagimin e komisionit të përpunimit të licencës.